



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:122480

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514498

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit V.M., me vendbanim në fshatin ..., komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.691/2023 të datës 16.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 18.03.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Mimoza Sylja-Hyseni prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri V.M. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Behar Sejda, e dëmtuara M.R. me përfaqësuesin me autorizim zëvendësues av Ali Beka pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, më datë 20.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 27.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri**

**V.M.:** nga i ati Q. dhe e ëma S., i lindur me datën ... në Gjakovë, me vendbanim në fshatin ..., komuna Malishevë, me numër personal ... i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fizik në sallonin e qeramikës “..” në Malishevë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse:

Me datën 09.04.2023, rreth orës 19:00 h, në fshatin ... Komuna Ferizaj, saktësisht përball restorantit G., duke drejtuar automjetin Daimler Chrysler ngjyrë e bardhë, me targa 04-..., ishte duke qarkulluar nga drejtimi i Shtimes në drejtim të Ferizajt, me të arritur përball restorantit G. në fshatin ..., nga pakujdesia shkel Ligjin për Trafikun Publik, konkretisht nenin 68 –Detyrimet e shoferit për tejkalim, në atë mënyrë që i pandehuri ka tejkaluar pa u siguruar se nuk ka automjete duke lëvizur nga drejtimi i kundërt dhe ka bërë tejkalim të pasigurt në rrugë, ku me pjesën e parë të automjetit e godet në pjesën e parë automjetin Renault Clio ngjyrë e bardhë me targa 05-... e cila ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt Ferizaj-Shtime, me ç’rast lëndime të rënda trupore kanë pësuar shoferi automjetit Renault Clio – tani e dëmtuara M.R., dhe bashkëudhëtarja e saj – tani e dëmtuara B.R., ndërsa lëndime të lehta trupore ka pësuar N.I., lëndime këto të konstatuara sipas ekspertizës - mjeko ligjore të datës 27.01.2024.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Rrezikimi i trafikut publik** nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 44, 69, 70, dhe 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

## G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro, të cilën shumë i pandehuri është e obliguar ta paguaj në 4 këste të barabarta, secili këst në vlerë prej 250 euro (dyqind e pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 4 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim, dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.

- III. Palët e dëmtuara B.R. me vendbanim në Rr. “,,,” në Ferizaj dhe M.R. me vendbanim rruga “,,,” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.
- IV. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale - ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumë prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A R S Y E T I M

### **1.Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 16.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.691/2023, kundër të pandehurit V.M. për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datë 18.03.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni prokurore në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri V.M. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Behar Sejda, e dëmtuara M.R. me përfaqësuesin me autorizim zëvendësues av Ali Beka.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 dhe 6 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

### **2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar

gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj me numër rendor 104 i datës 09.04.2023, Raporti nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj me numër rendor 1,, i datës 09.04.2023, Raporti nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me numër 2,, i datës 09.04.2023, Akt ekspertimi mjeko-ligjor me numër të referencës Fe-0,,/24 i datës 27.01.2024, konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 09.06.2023, i hartuar nga eksperti F.S., raporti i aksidentit me numër të rastit 2023-CFT-187 i datës 09.04.2023, certifikata e regjistrimit të automjetit me numër ..., polisa e sigurimit me numër ..., certifikata e regjistrimit të automjetit me numër 1..., deklarata e të dëmtuarës M.R. e dhënë në prokurori me datë 06.06.2023, deklarata e të pandehurit V.M. e dhënë në prokurori me datë 02.06.2023 dhe në polici me datë 09.04.2023, fotografitë e vendit të ngjarjes si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### **3.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i V.M., ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, i cili me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro, të cilën shumë e pandehura është e obliguar ta paguaj në 4 këste të barabarta, secili këst në vlerë prej 250 euro (dyqind e pesëdhjetë euro), brenda afatit prej 4 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe

përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike, është mbajtës i familjes si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, kurse rrethanë rënduese gjeti faktin se me këtë vepër penale janë dy palë të dëmtuara ( M.R. dhe B.R.) si dhe shkallën e dëmit të shkaktuar nga ana e të pandehurit.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të lartcekura, si dhe duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së i cili përcakton se: *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, gjykata nuk kufizohet me shkallën e përlllogaritjes të përcaktuar në nenin 43 paragrafi 3”*, gjykata vendosi që dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë ditëve) me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## **5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata*

*e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij program”. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

#### **6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Nga Formulari për kompensimin e ekspertëve mjeko –ligjor i datës 27.01.2024, përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën mjeko – ligjore në vlerë prej 50 (pesëdhjetë) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguaj shumën në vlerë prej 50 (pesëdhjetë) euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 09.06.2023 përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën e komunikacionit në vlerë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë euro), andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguaj shumën në vlerë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë euro).

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**2024:057042, me datë 27.03.2024**

**Zyrtarja Ligjore,**  
Ardita Tasholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Dardan Maloku

Numri i lëndës: 2023:122480  
Datë: 27.03.2024  
Numri i dokumentit: 05514498

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.